

## KONTRATË SHITJE E KUOTAVE TË SHOQËRISË

Më 07/11/2017 në selinë e Shoqërisë "BRAINACTIVE" shpk, e regjistruar në QKR (Qendra Kombëtare e Regjistrimit), me NIPT (Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm) L71812013U, në prani të palëve përkatëse u hartua kjo Kontratë Shitje e Kuotave të Shoqërisë:

### PALA – SHITËSI

Z. ZENO CARNIMEO i biri i Giuseppe, lindur në Bari Itali më, 12.04.1958 banues në Bari (Itali) shtetas italian, madhor, me zotësi të plotë juridike për të kuptuar dhe dëshiruar, me pashaporte N.AA3962709 ortak me 20% të kuotave në kompaninë BRAINACTIVE SH.P.K, si Shitës i 20 % të kuotave të shoqërisë në zotërim të tij, përfituesit:

### PALA – PËRFITUESE

Shoqëria HUHET, me NIPT L52304014T regjistruar më 04.11.2015 në QKR me Administrator Z. Vito Pellicani

Kjo kontratë nënshkruhet në përputhje me Ligjin nr. 9901, të datës 14/04/2008 "Për Shoqëritë Tregtare"; me Ligjin nr. 9723, të datës 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Shoqërive" dhe në bazë të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë shpk, dhe Vendimin Nr. 1 të datës 07/09/2017 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë BRAINACTIVE shpk.

### OBJEKTI

Ortaku ZENO CARNIMEO shet pjesën e tij prej 20% të kuotave të shoqërisë në zotërim të tij, duke i kaluar në pronësi të shoqërisë HUHET.

Në përputhje me Vendimin nr. 1 të Asamblese së Shoqërisë së Ortakëve të Shoqërisë BRAINACTIVE SH.P.K, në prezencë të palëve të interesuara hartojmë këtë kontratë shitje të kuotave të shoqërisë.

Në përfundim të aktit të shitjes së kuotave të shoqërisë dhe depozitimit të këtyre ndryshimeve të bëra pranë QKR-s Tiranë, pjesëmarrja në kapitalin e Shoqërisë BRAINACTIVE SHPK pëson këto ndryshime:

- Z. ZENO CARNIMEO, pas transferimit të kuotave të shoqërisë në emër të tij dhe pas regjistrimit të ndryshimeve në QKR, shkarkohet nga e drejta e pronësisë në këtë shoqëri.
- Shoqëria HUHET, pas transferimit të kuotave të shoqërisë në zotërim të saj dhe pas regjistrimit të ndryshimeve në QKR, bëhet pronare e 60 % të kuotave të shoqërisë BRAINACTIVE shpk ku deri më sot kishte 40% të kuotave.

Kjo kontratë shitje të Kuotave të Shoqërisë u hartua në dy faqe dhe në katër kopje me vlerë juridike të njëjtë, dhe u lexua në prezencë të palëve të interesuara me zë të lartë, të cilët e konsideruan besnik të vullnetit të shprehur dhe me liri të plotë veprimi sipas Ligjit në fuqi, u nënshkrua nga palët në prezencë të të interesuarve.

V. H. Pellicani  
M. D. Pallari  
Z. Carnimeo

Autorizohet Znj. Majlinda Haloçi për të depozituar këtë dokument pranë QKR-së duke futur të dhënat e regjistrimit të Shoqërisë "BRAINACTIVE" shpk, duke pasqyruar gjithashtu edhe ndryshimet e kryera në Strukturën e Shoqërisë.

**SHITËSI**

ZENO CARNIMEO

*Zeno Carnimeo*  
*Zeno Carnimeo*

**PËRFITUESI**

SHOQËRIA HUHET

Vito Pellicani

Massimo Pellicani

*Vito Pellicani*  
*Massimo Pellicani*



*prezantuar*  
*Alfred Halaçi*